



Prishtinë, 4 nëntor 2014

## DOKUMENT SHPJEGUES

mbi

### Arsyet e Mosaplikimit të NQ Termokos për Tarifat e Sezonit 2014/2015

#### 1. Hyrje

Në këtë dokument janë dhënë shpjegimet për arsyet lidhur me mos-aplikimin e NQ Termokos për tarifat e sezonit të ngrohjes 2014/2015. Arsyeja kryesore për këtë është e ndërlidhur me implementimin e projektit të kogjenerimit, respektivisht ndikimi i këtij projekti në ndryshimet e konsiderueshme në operimin dhe asetet e NQ Termokos. Po ashtu arsye shtesë është edhe performanca e dobët operative dhe financiare e NQ Termokos në sezonet e kaluara.

Këto shpjegime janë dhënë më detajisht në vijim të këtij dokumenti.

#### 2. Ndikimi i Projektit të Kogjenerimit në Ndryshimet në Operimin dhe në Asetet e NQ Termokos

Projekti i kogjenerimit përmban disa komponente specifike që kanë ndikim thelbësor në ndryshimin e operimeve të NQ Termokos e gjithashtu edhe në asetet e saj, krahasuar me operimin deritanishëm dhe asetet ekzistuese të NQ Termokos. Këto ndryshime të konsiderueshme kanë efekt në kostot operative (OPEX) dhe kostot kapitale (CAPEX) të ndërmarrjes që janë bazë për planifikimet (parashikimet) që duhet të përmbaj aplikacioni për tarifa.

##### 2.1 Ndikimi në Operimin / Kostot Operative të NQ Termokos

Ndryshimi kryesor është në prodhimin e energjisë termike (ngrohjes) e si rrjedhojë edhe në disa komponente tjera operative si: operimi i dy stacioneve të shkëmbimit të nxehtësisë – njëri në TC Kosova B dhe tjetri në NQ Termokos; operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të gypave transportues TC Kosova B – NQ Termokos në gjatësi prej rreth 11 km; operimi i sistemit të kontrollit dhe monitorimit kompjuterik të pajisjeve dhe të dhëva përkatëse përkatëse të kogjenerimit.

##### Prodhimi i energjisë termike (ngrohje)

- Në projektin e kogjenerimit sasia kryesore e energjisë termike (ngrohjes) do të përfitohet nga ekstraktimi i avullit prej turbinave të dy njësive B1 dhe B2 me kapacitet termik  $2 \times 70 \text{ MW}_{\text{TERMIK}}$ , ose në total  $140 \text{ MW}_{\text{TERMIK}}$ .
- Dy kaldajat me mazut në ngrohtoren e Termokosit, me kapacitet prej  $2 \times 58 \text{ MW}$  ose  $116 \text{ MW}$  në total, nuk do të dekomisionohen por do të shërbejnë si rezervë për tu kyçur në rast të ndonjë



ndërpreje të pa-planifikuar të njërive B1 ose B2, dhe për të plotësuar kërkesat për pikun e konsumit të ngrohjes.

#### Komponentet tjera operative

- Operimi i dy stacioneve të shkëmbimit të nxehtësisë – stacionit të shkëmbimit të nxehtësisë në TC Kosova B dhe Stacioni i shkëmbimit të nxehtësisë në NQ Termokos.
- Operimi i rrjetit të transportimit të ngrohjes në gjatësi prej afërsisht 11km nga TC Kosova B gjer në NQ Termokos.
- Fluidi bartës (uji ngrohtë) shtesë – Operimi me tre ujëra në vend të dy ujërave sa janë aktualisht: Uji prej stacionit të shkëmbimit të nxehtësisë në TC Kosova B përgjatë rrjetit transportues në shkëmbyesin në NQ Termokos; ujit i rrjetit primar të shpërndarjes, dhe uji i rrjetit sekundarë të ngrohjes;
- Operimi i sistemit të kontrollit dhe monitorimit të pajisjeve dhe të dhënave përkatëse të kogjenerimit.

#### Ndryshimi në Kostot Operative (CAPEX)

Ndryshimet e lartpërkruara në operimin e sistemit të ngrohjes qendrore të Termokosit afektojnë në ndryshimet të konsiderueshme në kostot operative (CAPEX) të NQ Termokos në krahasim me kostot e gjertanishme, të cilat janë renditur në vijim bashkë me shpjegimet bazë:

- Kostoja e prodhimit të energjisë termike (ngrohjes) që përmban dy komponente:
  - o Kostoja e energjisë termike (ngrohjes) së përfituar nga TC Kosova B – kjo kosto përmban ngarkesat për kapacitetin e rezervuar termik dhe sasinë e furnizuar të ngrohje dhe përcaktohet nga Marrëveshja e furnizimit me ngrohje KEK – Termokos, e cila ende nuk është finalizuar, nënshkruar nga palët dhe aprovuar nga ZRRE.
  - o Kostoja e ngrohjes së prodhuar në ngrohtore në kaldajat me mazut – kjo kosto është lehtë e planifikueshme sa i përket çmimit të mazutit, por që në rastin e implementimit të projektit duhet përcaktuar / parashikuar numrin e ditëve në operim. Për një parashikim real këtë duhet të dhënat së paku për një sezonë të ngrohjes.
- Kostot tjera operative – ndër këto më kryesoret janë:
  - o Kostja e operimit të dy stacioneve të shkëmbimit të nxehtësisë;
  - o Kostoja e operimit të rrjetit të transportimit të ngrohjes KEK – Termokos;
  - o Kostoja e fluidit bartës (ujit) – që është sasi shtesë për qarkun e mbyllur: Stacioni i shkëmbyesve TC Kosova B – Rrjeti i transportimit të ngrohjes - Stacioni i shkëmbyesve NQ Termokos;
  - o Kostoja e operimit të sistemit të kontrollit dhe monitorimit të pajisjeve dhe të dhënave përkatëse;
- Subvencioni për mazut – kjo është një komponent shtesë financiare e cila gjithashtu ka pësuar ndryshim si pasojë e projektit të kogjenerimit:



- Subvencioni i vitit kalendarik 2014 që ishte për pjesën e parë të sezonit 2014/2015, në vlerë prej 1,200,000 €, është shpenzuar për projektin e kogjenerimit për shkak të tejkalimit të shpenzimeve investive;
- Gjithashtu ishte paraparë që mos të ketë subvencione për lëndë djegëse në buxhetin e vitit 2015, sepse me përfundimin e projektit të kogjenerimit nuk do të ekzistonte arsyeja për këtë.

Pra nga sa u përmend më lartë projekti i kogjenerimit ndikon dukshëm në ndryshimin e kostove operative. Për këtë është menduar se nevojitet së paku një sezonë e ngrohjes për të mbledhur të dhënat për kostot operative faktikisht të realizuara, ashtu që në sezonin e ardhshëm (2015/2016) të mund të bëhen planifikime / parashikime sa më sakta për aplikimin për tarifa duke u bazuar në këto të dhëna të mbledhura.

## 2.2 Ndikimi në Asetet e NQ Termokos – ndikimi në CAPEX

Projekti i kogjenerimit ndikon shumë në asetet e NQ Termokos, ashtu që rrjedhimsht ndikon edhe në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB) që është komponenta bazë për llogaritjen e Zhvlerësimit dhe Kthimit në RAB pra CAPEX-it.

Si rrjedhojë e projektit të kogjenerimit asetet kryesore shtesë janë:

- Stacioni i shkëmbyesve të nxehtësisë në TC Kosova B;
- Rrjeti i transportit të ngrohjes TC Kosova B – NQ Termokos, në gjatësi prej afërsisht 11 km.
- Stacioni i shkëmbyesit të nxehtësisë në NQ Termokos;
- Pajisjet dhe instalimet shtesë të kyçjeve në turbinat e njëjësive B1 dhe B2 respektivisht kyçjes në rrjetin e shpërndarjes së NQ Termokos;

Duhet theksuar se shpenzimet e investimit për projektin e kogjenerimit paraqet një vlerë shumë të madhe në krahasim me asetet ekzistuese të NQ Termokos (sipas raportit të auditorit për vitin 2013 vlera e asetëve ekzistuese me 31.12.2013 është 5,087,185 €). Vlerësohet se investimet totale për këtë projekt do të arrijnë vlerën gjer në mbi 32 milion €, që është tejkalim në krahasim me vlerën e paralogaritur në studimin e fizibilitetit prej rreth 27 milion €. Shifra prej mbi 32 milion € ende nuk është e konfirmuar për shkak se projekti nuk ka përfunduar ende. Na është premtuar nga Njësia e implemetimit të projektit dhe KfW që të dhënat e sakta do të na vihen në dispozicion pasi që të kenë kryer vlerësimin e detajuar të kostove të investimit të projekteve që do të jetë i gatshëm pasi të kryhet projekti.

Në vijim është dhënë struktura e financimit të investimeve të projektit të kogjenerimit e cila ka qenë në periudhën e fillimit të realizimit të projektit:

- Donacion nga Komisioni Evropian -	13,825,000 €;
- Nga KfW 6,000,000 € donacion dhe 5,000,000 € kredi -	11,000,000 €;
- Donacion nga Komuna e Prishtinës -	2,000,000 €;
- Donacion nga Qeveria Suedeze -	1,800,000 €;
- Donacion nga Qeveria e Luxemburgut -	1,500,000 €;
- <b>Total -</b>	<b>30,125,000 €.</b>



Siç shihet nga shuma totale e paraparë prej 30,125,000 €, donacion është shuma prej 25,125,000 € ndërsa shuma prej 5,000,000 është kredi nga banka Gjermane për Zhvillim (KfW).

#### Ndryshimi në Kostot Kapitale (CAPEX)

Ndryshimi mjaft i madh në vlerën e aseteve si pasojë e realizimit të projektit të kogjenerimit ka ndikim shumë të madh në kostot kapitale, më saktësisht në:

- Zhvlerësimin e Aseteve Fikse – kjo kosto, e cila duhet të përfshihet në të Hyrat e Lejuara, llogaritet me normën përkatëse mesatare të zhvlerësimit në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB); dhe
- Kthimi në RAB (profiti) – gjithashtu kjo kosto është një ndër komponentet kryesore të të Hyrave të lejuara, që llogaritet me normën e kthimit (RoR-WACC) në asetet e vet-financuara (RAB<sub>F</sub> – që përfshin edhe asetet e financuara nga kredia).

Duke qenë se projekti është në fazën e realizimit dhe ende nuk ka përfunduar, problemi paraqitet në përcaktimin e RAB-it, sepse për shkak të tejkalimit të vlerës së investimeve të projektit, vonesave në realizimin e projektit dhe realizimit jo të plotë të projektit, ende nuk dihet vlera e aseteve / investimeve të reja.

Pra për të bërë planifikim sa më real të RAB-it nevojiten të dhënat më të kompletuara për asetet / investimet, që në këtë fazë ende nuk janë në dispozicion sepse projekti është në realizim e sipër. Pra nevojiten të dhëna të kompletuara për:

- Vlerën e Investimeve të reja – që kryesisht janë të ndërlidhura me projektin e kogjenerimit;
  - o Gjatë takimeve të përbashkëta me NQ Termokos dhe KfW – Njësinë e Implementimit të projektit për monitorimin e projektit jemi dakorduar që me përfundimin e projekti do përgaditet lista detaje dhe e saktë e aseteve të investuara në projektin e kogjenerimit të cilën do e dorëzojnë edhe në ZRRE.
- Vlera e mbetur e aseteve ekzistuese – këtu kryesisht ka të bëjë me vlerën e dy kaldajave me mazut me kapacitet total prej 116 MW<sub>TERMİK</sub> dhe pajisjeve tjera përcjellëse. Duke qenë se këto nuk parashihet të dekomisionohen por do të shfrytëzohen si rezervë për tu përdorur në rast të avarive të paplanifikuara në TC Kosova B dhe për të mbuluar pikun, atëherë vlera e tyre nuk duhet të merret e plotë por sipas shkallës së shfrytëzueshmërisë së pritur (në %). Për të qenë sa më saktë në planifikim do kishte qenë e preferueshme të ishin në dispozicion së paku për një sezon të dhënat numrin e ditëve / orëve që këto kaldaja janë shfrytëzuar prodhuar energji termike (ngrohje).

Pra nga më lartë mund të përfundohet se në këtë fazë kur nuk ende nuk ka përfunduar projekti ka shumë pikëpyetje për vlerën e investimeve dhe përgjithësisht të aseteve të cilat do të shfrytëzohen për ofrimin e shërbimit me ngrohje. Për këtë çdo parashikim për vlerën e RAB ishte duhur të bazohej në vlera të pakonfirmuara dhe jo të kompletuara. Rrjedhimisht edhe parashikimi i kostove kapitale – zhvlerësimi dhe Kthimi në RAB – do ishte mjaft joreal dhe diskutabil, dhe që do ndikonte mjaft shumë në parashikimin e përgjithshëm të Ardhurave të lejuara dhe në përcaktimin e tarifave.



### 3. Performanca Operative dhe Financiare e NQ Termokos

Siç dihet, sidomos në dy sezonet e kaluara, performanca operuese dhe ekonomiko-financiare e NQ Termokos ka qenë mjaft e dobët, që paraqet një vështirësi shtesë për të kryer planifikime (parashikime) të mirëfillta për përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe tarifave.

#### 3.1 Performanca Operuese

Performanca operuese e NQ Termokos, në kuptim të prodhimit dhe furnizimit të konsumatorëve me ngrohje (energji termike), ka qenë mjaft e dobët. Për shkak të vështirësive financiare që ka pamundësuar sigurimin e sasive të mjaftueshme të mazutit, prodhimi i energjisë termike ka qenë dukshëm nga ai i planifikuar në shqyrtimet përkatëse tarifore. Kjo më tutje ka ndikuar në furnizim të pamjaftueshëm të konsumatorëve me ngrohje - pra përgjithësisht furnizimi ka qenë me ndërprerje të shumta dhe jocilësorë. Si shembull konkret, në sezonin e kaluar 2013/2014 furnizimi me ngrohje ka filluar në fund të nëntorit 2013 dhe ka përfunduar në mes të marsit 2014 – pra as 4 muaj të plota. Gjithashtu edhe brenda kësaj periudhe ka pasur ndërprerje të shkurtëra si dhe ngrohja ka qenë jocilësore

Për të ilustruar performancën e dobët të NQ Termokos në prodhimin dhe furnizimin e konsumatorëve me ngrohje, në vijim në formë të përmbledhur janë paraqitur të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit të sezonit të kaluar 2013/2014.

#### Furnizimi dhe konsumi i mazutit – sezoni 2013/2014

Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të dhënat e monitoruara për furnizimin me mazut dhe konsumin e mazutit gjatë sezonit të kaluar.

Furnizimi me mazut dhe konsumi – NQ Termokos, sezoni 2013/2014									
		10/20 13	11/201 3	12/201 3	01/201 4	02/201 4	03/201 4	Total	
1	Sasia e furnizimit me mazut [ton]	-	-	-	-	-		<b>5,459.86</b>	
2	Konsumi i mazutit [ton]	18.62*	794.24	1,703.86	1,359.33	983.56	533.74	<b>5,393.35</b>	
3	Rezervat e mazutit në fillim të sezonit [ton]								<b>180</b>
4	Rezervat e mazutit në fund të sezonit [ton]								<b>245.65</b>

\* sasia e mazutit e konsumuar në tetor ka qenë vetëm për testim në kuadër të përgatitjeve për sezonin e ngrohjes



Në vijim është dhënë një paraqitje krahasuese e konsumit të lëndës djegëse me sasi të planifikuara

NQ Termokos – konsumi i mazutit në sezonin 2013/2014			
Planifikuar	Realizuar [ton]	Ndryshimi [ton]	Realizimi [%]
11,700.00	5,393.35	6,306.65	46.10

Pra siç mund të vërehet nga të dhënat e lartë përmendura sasia e furnizimit me mazut ka qenë 5,459 ton, ndërsa konsumi i mazutit 5,393 ton, që në krahasim me planifikimet (parashikimet) paraqet një realizim prej vetëm 46%.

#### Prodhimi, Furnizimi dhe Humbjet në Sistem

Pamundësia financiare për të siguruar sasi të mjaftueshme të mazutit ka ndikuar në mënyrë zinxhimore në prodhimin e ngrohjes dhe furnizimit me ngrohje.

NQ Termokos Bilanci i energjisë termike – sezoni 2013/2014						
Energjia nga lënda djegëse	Gjenerimi neto i ngrohjes	Humbjet e gjenerimit	Efikasiteti i ngrohjes	Humbjet e shpërndarjes	Furnizimi	
[MW <sub>T</sub> h]	[MW <sub>T</sub> h]	[MW <sub>T</sub> h]	[%]	[MW <sub>T</sub> h]	[%]	[MW <sub>T</sub> h]
60,952.20	51,528.21	3,328.77	84.53	9,723.79	18.87	41,804.42

Prodhimi dhe furnizimi me ngrohje i realizuar në sezonin 2013/2014 është dukshëm më i vogël krahasuar me parashikimet (planifikimet) përkatëse të gjatë shqyrtimeve tarifore të sezoneve të kaluara. Realizimi i prodhimit dhe furnizimit me ngrohje është paraqitur në tabelën vijuese.

Realizimi i prodhimit dhe furnizimit me ngrohje – sezoni 2013/2014			
	Planifikuar	Realizuar	% e Realizimit
Prodhimi neto i ngrohjes [MWh <sub>T</sub> ]	118,989	51,528	43.3 %
Furnizimi me ngrohje [MWh <sub>T</sub> ]	104,710	41,804	39.92 %

Nga të dhënat e mësipërme mund të vërehet një realizim mjaft i vogël i të gjithë parametrevë kryesor të operimit të NQ Termokos, e cila afekton negativisht në parashikimet përkatëse për përcaktimin e të hyrave të lejuara dhe tarifave. Më konkretisht ndikimi më i madh është në planifikimin e kostos së mazutit, që paraqet koston kryesore, si dhe në planifikimin e sasive të prodhimit të energjisë termike (ngrohjes) dhe të furnizimit të konsumatorëve me ngrohje.



### 3.2 Performanca financiare

Fillimisht duhet theksuar se performanca financiare e NQ Termokos është mjaft e ulët, që kryesisht është pasoj e faturimit më të ulët se ai i planifikuar dhe nivelit të ulët të arkëtimit të pagesave.

Në vijim paraqiten të dhënat përkatëse të monitorimit që janë realizuar në sezonin 2013/2014.

Ndërmarrja		N.Q."Termokos" sh.a		Periudha		Sezoni 2013/ 2014	
<b>Pasqyra e Faturimit dhe Arkëtimit të Pagesave</b>							
Sezoni Ngrohës 2013 - 2014							
	Shitja e Ngrohjes nga Grupi I Konsumatorëve	Sipërfaqja Ngrohëse [m2]	Faturuar [Euro]	Arkëtuar [Euro]	Shkalla e Arkëtimit [%]	Borgji [Euro]	Borgji [%]
1	Shtëpijak (Arvizri)	634,557.45	1,223,844.06	220,585.79	18.02	1,003,258.27	81.98
2	Komercial dhe Institucional	391,918.02	1095758.07	859092.65	78.40	236,665.42	21.60
3	Total	1,026,475.47	2,319,602.13	1,079,678.44	46.55	1,239,923.69	53.45

Siç vërehet nga tabela e mësipërme faturimi është dukshëm më i vogël se i planifikuar, e që kjo është kryesisht pasoj e mos-faturimit për muajt që nuk ka pasur fare furnizim me ngrohje (sezoni i ngrohjes ka filluar në fund të nëntorit 2013 dhe ka përfunduar në mes të marsit 2014), si dhe zbritjet në fatura për ndërprerjet e shpeshta disa ditore dhe për cilësinë e ngrohjes. Nëse i referohemi të hyrave të lejuara (pra nga shitja e ngrohjes) siç janë përcaktuar në shqyrtimin e fundit tarifor në vlerë prej 6,433,000 € shihet se realizimi i faturimit është rreth 36%.

Situatë po ashtu e rënduar është edhe në arkëtimin e pagesave nga konsumatorët, ku shkalla e përgjithshme e arkëtimit për dy grupet e konsumatorëve është 46.55%.

Faturimi dhe arkëtimi i ulët kanë ndikim direkt në situatën e vështirë financiare në të cilën aktualisht gjendet NQ Termokos. Mungesa e mjeteve financiare të mjaftueshme për mbuluar shpenzimet e operimit, pamundëson në radhë të parë sigurimin e mazutit në sasi të mjaftueshme për një furnizim të qëndrueshëm me ngrohje. Për këtë, gjatë planifikimit të kostove, paraqiten një numër dilemash në kuptim të mundësive reale financiare të kufizuar për të mbuluar kostot përkatëse.



### Subvencionet

Për shkak të vështirësive financiare të përmbledhura më lartë, NQ Termokos në vazhdimësi ka pranuar subvencione nga buxheti i Kosovës, por edhe nga Komuna, me të cilat deri diku është rritur aftësia e tyre financiare për të paguar për koston e mazutit.

Si ilustrim paraqiten të dhënat për subvencionet e pranuar në sezonin 2013/2014

Nga Buxheti i Kosovës -	<b>2,402,538.17 €;</b>
Nga Komuna e Prishtinës -	<b>500,000.00 €</b>
<b>Total Subvencione -</b>	<b>2,902,538,17 €</b>

Mirëpo për shkak se ka qenë planifikuar që projekti i kogjenerimit të përfundoj para fillimit të këtij sezoni dhe të funksionalizohet përfitimi i ngrohjes nga TC Kosova B, atëherë nuk ishte paraparë ndonjë vlerë përfundimtare për subvencion.

Duke ditur se subvencionet kanë pasur një pjesëmarrje të madhe në mbulimin e kostove, dhe nisur nga qasja që konsumatorët të mos ngarkohen për kostot që janë mbuluar nga subvencionit, gjatë përcaktimit të të Hyrave të lejuara shuma e subvencionit është zbritur. Për këtë shkak mungesa e ndonjë indikacioni pak a shumë të sigurt për vlerën e subvencionit, e bën parashikimin për subvencion mjaft të diskutueshëm, dhe me ndikim mjaft negativ nëse gabohet në këtë parashikim.

Nga sa u tha më lartë mund të përfundohet se gjithashtu edhe performaca e dobët operuese dhe financiare paraqet vështirësi për të kryer parashikimet reale të nevojshme për aplikim tarifor të kompletuar.